

**VENDIM**  
**Nr. 267, datë 7.5.2014**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SUBSTANCAVE**  
**PRIORITARE NË MJEDISËT UJORE<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 1, shkronja “a”, e 29, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së substancave prioritare, që paraqesin rrezik të konsiderueshëm për/apo nëpërmjet mjedisit ujor, sipas aneksit I që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Termi “substancë prioritare” ka kuptimin e dhënë në pikën 63, të nenit 4, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Këshilli Kombëtar i Ujit dhe këshillat e baseneve ujëmbledhëse, që, në zbatimin të kompetencave të tyre ligjore për mbrojtjen e cilësisë së ujërave, të marrin në konsideratë këtë listë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

---

<sup>1</sup> Vendimi është në përputhje të pjesshme me direktivën 2013/39/BE, të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 12 gusht 2013, duke ndryshuar direktivat 2000/60/KE dhe 2008/105/KE në lidhje me substancat prioritare në fushën e politikave të ujërave, nr. Celex OJ C/2013/39/1.

**Aneksi I. Lista e Substancave Prioritare në mjediset ujore**

ANEKS

LISTA E SUBSTANCAVE PRIORITARE NE FUSHEN E POLITIKAVE TE UJERAVE

Numri	Emri i substancës <sup>(1)</sup> prioritare	Numri CAS <sup>(2)</sup>	Numri EU <sup>(3)</sup>	Identifikuar si substanca të rrezikshme prioritare
1	Alaklori	15972-60-8	240-110-8	
2	Antraceni	120-12-7	204-371-1	X
3	Atrazina	1912-24-9	217-617-8	
4	Benzeni	71-43-2	200-753-7	
5	Difenileteri i bromuar <sup>(4)</sup>	I pa aplikueshëm	I pa aplikueshëm	X <sup>(5)</sup>
	Pentabromodifenileteri (numrat e elementeve të të njëjtit grup 28, 47, 99, 100, 153 dhe 154)	32534-81-9	I pa aplikueshëm	
6	Kadmiumi dhe përbërjet e tij	7440-43-9	231-152-8	X
7	C10-13 Kloroalkanet <sup>(4)</sup>	85535-84-8	287-476-5	X
8	Klorfenvinfos	470-90-6	207-432-0	
9	Klorpirifosi (Klorpirifos-etili)	2921-88-2	220-864-4	
10	1,2-Dikloroetani	107-06-2	203-458-1	
11	Diklorometani	75-09-2	200-838-9	
12	Di(2-etilheksil)-ftalat (DEHP)	117-81-7	204-211-0	
13	Diuroni	330-54-1	206-354-4	
14	Endosulfani	115-29-7	204-079-4	X
15	Fluoranteni <sup>(6)</sup>	206-44-0	205-912-4	
16	Hekzakloro-benzeni	118-74-1	204-273-9	X

Numri	Emri i substancës <sup>(1)</sup> prioritare	Numri CAS <sup>(2)</sup>	Numri EU <sup>(3)</sup>	Identifikuar si substanca të rrezikshme prioritare
17	Hekzakloro-butadieni	87-68-3	201-765-5	X
18	Hekzakloro-cikloheksani	608-73-1	210-158-9	X
19	Izoproturoni	34123-59-6	251-835-4	
20	Plumbi dhe përbërjet e tij	7439-92-1	231-100-4	
21	Mërkuri dhe përbërjet e tij	7439-97-6	231-106-7	X
22	Naftaleni	91-20-3	202-049-5	
23	Nikeli dhe përbërjet e tij	7440-02-0	231-111-14	
24	Nonilfenoli	25154-52-3	246-672-0	X
	4-Nonilfenoli	104-40-5	203-199-4	X
25	Oktilfenoli	1806-26-4	217-302-5	
	(4-(1,1',3,3'-tetrametilbutil)-fenoli)	140-66-9	I pa aplikueshëm	
26	Pentakloro-benzeni	608-93-5	210-172-5	X
27	Pentakloro-fenoli	87-86-5	231-152-8	
28	Hidrokarburet poliaromatike (HPA)	I pa aplikueshëm	I pa aplikueshëm	X
	Benzo(a)pireni	50-32-8	200-028-5	X
	Benzo(b)fluor-anteni	205-99-2	205-911-9	X
	Benzo(g,h,i)-perileni	191-24-2	205-883-8	X
	Benzo(k)fluor-anteni	207-08-9	205-916-6	X
	Indeno(1,2,3-cd)-pireni	193-39-5	205-893-2	X
29	Simazina	122-34-9	204-535-2	
30	Përbërjet e tributiltinës	I pa aplikueshëm	I pa aplikueshëm	X
	(Tributiltin-kimi)	36643-28-4	I pa aplikueshëm	X
31	Trikloro-benzenet	12002-48-1	234-413-4	

Numri	Emri i substancës <sup>(1)</sup> prioritare	Numri CAS <sup>(2)</sup>	Numri EU <sup>(3)</sup>	Identifikuar si substanca të rrezikshme prioritare
32	Trikloro-metanut (kloroforma)	67-66-3	200-663-8	
33	Trifluralina	1582-09-8	216-428-8	

Shënime për Tabelën:

- (1) Në rastet kur grupet e substancave janë zgjedhur, përfaqësues tipikë individualë listohen si parametra tregues (në kllapa dhe pa numër). Për këto grupe substancash, parametri tregues duhet të përcaktohet nëpërmjet metodës analitike.
- (2) CAS: Shërbimi Kimik Abstrakt
- (3) Numri EU: Inventari Evropian i Substancave Tregtare Ekzistuese (EINECS) ose Lista Evropiane e Substancave Kimike të Shpallura (ELINCS).
- (4) Këto grupe substancash normalisht përfshijnë një numër të konsiderueshëm përbërjesh individuale. Aktualisht, nuk mund të jepen parametra tregues të përshtatshëm.
- (5) Vetëm Pentabromobifenileteri (numri CAS 32534-81-9).
- (6) Fluoranteni është në listë si tregues i hidrokarbureve të tjera poliaromatike më të rrezikshme.

